



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DREJTORIA E METODOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT**

**PROGRAM TRAJNIMI**

**Muaji Korrik 2021**

Referuar Plan-Veprimit mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Audituesve të KLSH-së” për vitin 2021, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 14 datë 08.02.2021, gjatë muajit Korrik 2021, **u zhvillua trajnimi sipas Programit të mëposhtëm, ku morën pjesë 71 auditues.**

**Fokusi i trajnimit: “Trajnim mbi Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH & Manualët e auditimit”**

Nr.	Temat	Trajnuesit
1.	<p>Trajnim mbi Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH</p> <p>Do të trajtohen, kryesisht problematikat e dala gjatë zbatimit të saj, vërejtje e sugjerime për përmirësim të procedurave. Vërejtje konkrete nga departamentet, për këtë arsye është kërkuar pjesëmarrja e Kryeaudituesit të Departamentit</p>	<p><b>Brunilda Zeneli</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ <b>Diploma: Financë</b></li><li>- Postmaster në Administrim Biznes; UP “S &amp; P Qirjazi”;</li><li>- Certifikatë “Kontabël i miratuar në sektorin publik” CIPFA-CEF</li><li>- Certifikatë Auditues i Brendshëm, Ministria e Financave;</li><li>- Certifikatë “Vlerësues i pasurive të paluajtshme”, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit;</li></ul>
2.	<p>Mbi manualët e auditimit, fokusi:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>a. identifikimi i risqeve;</li><li>b. përcaktimi i materialitetit;</li><li>c. dhënia e opinionit të auditimit.</li></ol> <p>Do të trajtohen, kryesisht problematikat e dala gjatë zbatimit të tyre, vërejtje e sugjerime për përmirësim. Vërejtje konkrete nga departamentet, për këtë arsye është kërkuar pjesëmarrja e Kryeaudituesit të Departamentit</p>	<p><b>Bexhet Zeqiri</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ <b>Diplomimi: Kontabilist</b></li><li>- Certifikuar në Programin “Financa”, për Kontabilitet të informatizuar;</li><li>- Certifikuar në fushën e Prokurimeve publike me mjete Elektronike, APP-2009</li></ul> <p><b>Ina Sokoli</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ <b>Diploma: Financë</b></li><li>- Master shkencor “Matematikë, Financë”, Fakulteti i shkencave teknike, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë;</li><li>- Doktoraturë në Financë, Fakulteti Ekonomik, Tiranë;</li><li>- Certifikuar si Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik, MFE, Njësia e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.</li><li>- Certifikuar si Kontabël i Miratuar.</li></ul>

**Target grupi:** Trajnimi do të organizohet, sipas nevojave të departamenteve, por me pjesëmarrjen e Kryeaudituesit të Departamentit, i ndarë në dy grupe dhe me shtrirje në 12 ditë.

## Kalendari i realizimit të trajnimeve:

### Muaji Korrik, 2021

E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E dielë
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14-RR	15-RR	16	17	18
19-RR	20-RR	21-MF	22-MF	23-MF	24	25
26-MF	27-MP	28-MP	29-MP	30-MP	31	

- Nga data 3-4 Korrik, përgatitja e Programit të trajnimeve;
- Nga data 9-14 Korrik, përgatitja e temave nga trajnuesit;
- Nga data 14-30 Korrik, zhvillimi i trajnimeve.

- **Kohëzgjatja e trajnimit:** Trajnimi do të zgjasë 1.30 orë.

Departamentet	Nr. Auditues pjesëmarrës	Tema e parë Dita e parë	Tema e dytë Dita e dytë	Tema e tretë Dita e tretë	Trajnerët	Mbikëqyrja Drejtoria e Metodologjisë
1-Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	5 Auditues 1 K/auditues	Rregullorja e Procedurave	Manuali i Auditimit Financiar	Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë	Brunilda Zeneli  Bexhet Zeqiri	Safete Pojani
2-Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore	5 Auditues 1 K/auditues				Ina Sokoli	
3-Departamenti i Auditimit IT	3 Auditues 1 K/auditues					
4-Departamenti i Auditimit të Performancës	5 Auditues 1 K/auditues					
Departamentet	Nr. Auditues pjesëmarrës	Tema e parë Dita e dytë	Tema e dytë Dita e dytë	Tema e tretë Dita e dytë	Trajnerët	Mbikëqyrja Drejtoria e Metodologjisë
1-Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore	5 Auditues 1 K/auditues	Rregullorja e Procedurave	Manuali i Auditimit Financiar	Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë	Brunilda Zeneli  Bexhet Zeqiri	Safete Pojani
2-Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit	5 Auditues 1 K/auditues				Ina Sokoli	
3-Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Financimit të Huaj	5 Auditues 1 K/auditues					

## Kalendari i trajnimit

Departamentet	Tema	Data	Orari	Trajnerë
1-Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit 2-Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore 3-Departamenti i Auditimit IT 4-Departamenti i Auditimit të Performancës	Rregullorja e Procedurave të Auditimit	14.07.2021 15.07.2021	09-10.30	Brunilda Zeneli
1-Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore 2-Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit 3-Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Financimit të Huaj	Rregullorja e Procedurave të Auditimit	19.07.2021 20.07.2021	09-10.30	Brunilda Zeneli
1-Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit 2-Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore 3-Departamenti i Auditimit IT 4-Departamenti i Auditimit të Performancës	Manuali i Auditimit Financiar	21.07.2021 22.07.2021	09-10.30	Bexhet Zeqiri
1-Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore 2-Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit 3-Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Financimit të Huaj	Manuali i Auditimit Financiar	23.07.2021 26.07.2021	09-10.30	Bexhet Zeqiri
1-Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit 2-Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore 3-Departamenti i Auditimit IT 4-Departamenti i Auditimit të Performancës	Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë	27.07.2021 28.07.2021	09-10.30	Ina Sokoli
1-Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore 2-Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit 3-Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Financimit të Huaj	Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë	29.07.2021 30.07.2021	09-10.30	Ina Sokoli

### Elementët e trajnimit:

- **Skedulimi**
- **Zhvillimi**
- **Kontrolli**
- **Vlerësimi**

### **Që të realizohet një proces trajnimi optimal, duhet të plotësojmë disa kushte:**

- Sigurimi i teknikës së nevojshme: Trajnimi do të zhvillohet online, nëpërmjet Platformës “Microsoft Skype”. Trajnerët para orës së trajnimit duhet të dërgojnë me email, të gjithë audituesve të përcaktuar për të ndjekur trajnimin, linkun ku do të aksesojnë;
- Sigurimi i materialeve të nevojshme: Të gjithë audituesit, kanë akses të plotë mbi materialet të cilat do të jenë objekt i këtij trajnimi. Standardet, rregulloret, udhëzues, ligji organik i KLSH-së etj., janë të publikuara në faqen ëeb të KLSH-së.
- Sigurimi i trajnerëve të aftë: Nga lista e trajnerëve janë përzgjedhur trajnerë, të cilët kanë kompetencën e duhur profesionale në drejtimet përkatëse të trajnimit.

**Skedulimi i programit:** Skedulimi i programit është bërë duke patur në konsideratë ngarkesën në punë të audituesve, Zhvillimi online është një lehtësi, pasi ndjekja e trajnimit mund të kryhet nga vendet e punës, pa prezencë fizike. Është shtrirë në 12 ditë, me fokus Manualin e auditimit Financiar dhe Përputhshmëri, si dhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit. Trajnimi do të jetë dy orë në ditë, duke mos cenuar veprimtarinë audituese të gjithsecilit.

**Zhvillimi i trajnimit:** Zhvillimi i trajnimit, është konkretizimi i të gjitha etapave të mëparshme të procesit të trajnimit si; përcaktimi i nevojave, planifikim-programimi dhe skedulimi.

Në etapën e zhvillimit të trajnimit ndikojnë disa faktorë:

- Përzgjedhja e platformave të ndryshme on-line;
- Përgatitja e lektorëve, sa ata e bëjnë tërheqës trajnimin;
- Përgatitja dhe interesi i pjesëmarrësve, sa ata kanë interes rreth çështjeve që trajtohen, kjo është e lidhur ngushtë me etapën e parë të këtij procesi me përcaktimin e nevojave dhe sa janë të përgatitur pjesëmarrësit.

**Kontrolli:** Gjatë procesit të zhvillimit të trajnimit është e rëndësishme që në mënyrë permanente të ndiqet sa është realizuar dhe si janë realizuar objektivat që janë programuar për t'u realizuar. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet disa mënyrave:

- Testimi i reagimit të pjesëmarrësve gjatë zhvillimit të trajnimit, kjo nuk teston njohuritë e tyre, por mund të vlerësojë pozitivisht interesin e tyre, për çështje të veçanta dhe vlerësimin për trajnerë të veçantë;
- Testimi i njohurive, në fund të zhvillimit të seancave për çështje të caktuara;
- Shembuj konkretë duke punuar në grupe të vogla, vlerësimi i tyre;
- Debateve dhe konkluzioneve në fund të çdo seance, etj.

**Vlerësimi i trajnimit:** Vlerësimi i trajnimit është etapë me rëndësi, pasi mbledh të dhënat e nevojshme për të përcaktuar nëse procesi i trajnimit ishte i efektshëm.

Vlerësimi i programi i trajnimit: *(Plotësimi i pyetësorit të përgatitur nga trajnuesit, nga ana e audituesve, pjesëmarrës në trajnim)*

- Për të përcaktuar nëse trajnimi ka kontribuar në arritjen e qëllimeve të auditimit;
- Për të vlerësuar si dhe sa, të trajnuarit perfeksionuan njohuritë e tyre në këtë proces trajnimi;
- Për të vlerësuar metodat e përdorura në trajnim, nëse ato e ndihmuan të trajnuarin në arritjen e objektivave të trajnimit.
- Për të dizajnuar sa më mirë trajnimin e ardhshëm duke vlerësuar se ku ishin të metat dhe dobësitë e trajnimit të kryer.
- Për ta bërë në këtë mënyrë trajnimin një mjet sa më efikas
- Për të justifikuar koston e trajnimit, pasi KLSH investon në mënyrë që të përfitohen avantazhet e programuara.

**Drejtore**

**Brunilda Zeneli**